

VENDIM
Nr.534, datë 22.11.1999

PËR PAGIMIN E TVSH-SË SI KOSTO VENDORE PËR KONTRATËN ME “DELOITTE & TOUCHE”, SI ADMINISTRUESE E PESË SHOQËRIVE HUAMARRËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 9, të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997, “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Grupit të Mbikqyrjes së shoqërive huamarrëse, në buxhetin e shtetit për vitin 1999 i shtohet fondi prej 135 500 000 (njëqind e tridhjetë e pesë milionë e pesëqind mijë) lekësh, për të përballuar pagesën e TVSH-së, për shpërblimin e kryer nga “Deloitte & Touche”, si administruese e pesë shoqërive huamarrëse, caktuar si e tillë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.501, datë 24.11.1997.

2. i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3.Ngarkohen Ministria e Financave dhe Grupi i Mbikëqyrjes së shoqërive huamarrëse për batimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn n fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta